

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot, më datë 30.1.2007, midis Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH), të quajtura Palë, këtu dhe më poshtë, në përputhje me statusin e tyre institucional, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi, nënshkruhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi.

Palët në këtë Marrëveshje bien dakord sa më poshtë:

Neni 1

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është angazhimi i Palëve, të udhëhequra nga vullneti për të respektuar dhe zbatuar ligjin, për krijimin e kushteve sa më optimale lidhur me ndriçimin e pandërprerë të godinave të objekteve zgjedhore, në funksion të zhvillimit të zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Neni 2

Palët në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi veprojnë në përputhje me ligjin nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

Neni 3

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare merr përsipër të furnizojë me energji elektrike, nëpërmjet linjave të saj, në mënyrë të pandërprerë, të gjitha objektet zgjedhore në të gjithë territorin e vendit, si më poshtë:

1. Godina e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (Pallati i Kongreseve Tiranë), gjatë gjithë periudhës zgjedhore.
2. Godinat e magazinave në fshatin Lundër, komuna Farkë, Tiranë gjatë gjithë periudhës zgjedhore.
3. Godinat e qendrave të votimit në të gjithë territorin e vendit, nga ora 08:00 e datës 17 shkurt 2007 deri në orën 24:00 të datës 18 shkurt 2007.
4. Godinat e KZQV-ve dhe vendet e numërimit të votave në të gjithë territorin e vendit, nga ora 08:00 e datës 18 shkurt 2007 deri në orën 24:00 të datës 20 shkurt 2007.

Neni 4

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr përsipër të identifikojë dhe të vërë në dispozicion të Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare listën e plotë të objekteve zgjedhore dhe adresat e sakta të vendndodhjes së tyre. Ky identifikim do të bëhet për çdo qendër votimi, KZQV dhe VNV në rang njësie vendore, rrethi dhe qarku.

Neni 5

KESH merr përsipër të përballojë dhe të eliminojë defektet e mundshme në linjat e saj gjatë kësaj periudhe në këto objekte, nëpërmjet punonjësve të degëve dhe nëndegëve vendore. Këta të fundit do të mbajnë kontakte të përhershme sidomos me drejtuesit e KZQV-ve dhe KQV-ve.

Neni 6

KQZ dhe KESH angazhohen të shqyrtojnë në mënyrë të ndërsjellë kërkesat dhe propozimet e dyanshme dhe të mbajnë kontakte të rregullta nëpërmjet strukturave përgjegjëse.

Neni 7

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Tiranë, 30.1.2007